



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a.

Përgjigje në Raportin Konsultativ të ZRRE-së

Dorëzuar më 12 mars 2012

I. Hyrje

Kjo është përgjigjja e KEK-ut lidhur me çështjet e ngritura në Raportin Konsultativ të ZRRE-së (RK) të lëshuar më 27 shkurt 2012. KEK-u pajtohet me ZRRE-në në shumë çështje dhe për disa çështje të rëndësishme, mbi të cilat KEK-u nuk pajtohet me pozicionin e ZRRE-së, ne kemi paraqitur arsyetimin për mospajtim, e po ashtu edhe përshtatjet e propozuara respektive.

II. Sigurimi i Transparencës – Qartësimi i Pozicionit të ZRRE-së

a) Thurja e Kostove

Në pajtim me Rregullën e ZRRE-së për Vendosjen e Çmimeve dhe me Praktikën më të Mirë Ndërkombëtare, KEK-u ka dorëzuar Aplikimin e tij Tarifor për vitin 2012 në pesë pjesë, për qëllime të transparencës dhe në mënyrë që të zhvillohet vendosja e çmimeve të shthurura për Gjenerimin, Rrjetin e Shpërndarjes dhe Furnizimin e KEK-ut. Këto çmime individuale janë përdorur atëherë në mënyrë transparente për të zhvilluar tarifat e propozuara me pakicë. ZRRE ka zgjedhur që të mos i përdorë informacionet e detajizuara të dorëzuara nga KEK-u, mirëpo ka zgjedhur që t'i thurë të gjitha kostot e KEK-ut dhe KOSTT-it dhe t'i adresojë vetëm tarifat me pakicë. ZRRE-ja thekson se atyre ju duhet kohë për të rishikuar informatat mbi tarifat e shthurura të dorëzuara nga KEK-u. KEK-u beson se është dhënë kohë e mjaftueshme për rishikimin e këtyre materialeve, veçanërisht meqë KEK-u ka siguruar po ashtu informacionet për tarifat e shthurura në rishikimin e mëparshëm tarifor. Vendosja e çmimeve të shthurura është një komponentë aq e rëndësishme e zhvillimit tarifor efikas, prandaj ajo kërkohet për transparencë dhe qeverisje të mirë. Vendosja e çmimeve në detaje për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes është shumë e rëndësishme nëse Kosova shpreson t'i ketë konsumatorët 35KV, 10 KV ose konsumatorët e mëdhenj 0.4 KV që ushtrojnë statusin e konsumatorit të privilegjuar. Është po ashtu e rëndësishme që KKDFE të ketë vendosje specifike të çmimeve për shërbimet e saj të shpërndarjes, meqë ajo nuk do të thuret me Gjenerim.

b) Refuzimi për të Lëvizur drejt Tarifave Kosto Reflektive

Në katër rishikimet e kaluara tarifore (2008 deri 2011), KEK-u ka paraqitur në ZRRE një analizë të kostos për t'i shërbyer secilës kategori të konsumatorit. Meqë ZRRE-ja nuk e ka zhvilluar një analizë të saj dhe nuk e ka ndarë atë me KEK-un, ata së paku mund të përdorin informacionet e siguruar nga ana e KEK-ut si pikë fillestare për analizën e tyre të kostos së shërbimeve. Edhe pse është shumë e qartë se tarifat e Amvisërisë janë shumë më të ulëta se kosto (nuk nevojitet asnjë studim – mund të vini në përfundim vetëm duke shikuar çmimin mesatar për kWh për secilën kategori të konsumatorëve), ZRRE refuzon të marrë vendime të vështira të nevojshme për të

lëvizur drejt tarifave kosto reflektive. Për të dytin vit me radhë, KEK-u ka ofruar informacione të detajizuara mbi tarifatat e shthurura për secilën komponentë të koston (energjinë me shumicë, transmissi, shpërndarja dhe furnizimi) për secilën kategori të konsumatorëve. Përsëri, ZRRE lë të kuptohet se në vitin e kaluar ata nuk kanë pasur kohë t'i rishikojnë këto informacione. Është e qartë se në këtë rishikim tarifor, ZRRE nuk ka pasur ndër mend të jetë në përputhje me Direktivat e BE-së për Energji Elektrike ose të bazohet në Nenin 40, paragrafi 2 i Ligjit të Kosovës për Rregullatorin e Energjisë i cili kërkon që tarifatat të ri-balancohen në mënyrë graduale, deri më 31 dhjetor 2014, deri në nivelet e koston reflektive për secilën kategori të konsumatorëve.

c) Qartësimi i Bilancit Energjetik

ZRRE-ja ka paraqitur detajet e bilancit energjetik në një tabelë të RK. Në përgjithësi, ZRRE-ja ka paraqitur në mënyrë të drejtë shifrat e energjisë në aplikimin e KEK-ut, megjithatë për qëllime të transparencës KEK-u mendon se shpalosja e kategorive të humbjeve në shpërndarje është e nevojshme dhe është bërë në Tabelën A. Vendimi 399 i lëshuar nga ZRRE më 6 shkurt 2012 dhe RK ka përmbledhur të gjitha humbjet në shpërndarje bashkë, të cilat nuk do ta lehtësojnë analizën në të ardhmen.

KEK-u kundërshton përfshirjen e "Humbjeve Politike" (energjinë e pafaturuar e siguruar në Veri të Kosovës) si humbje të shpërndarjes nga ana e ZRRE-së. Ajo energji kurrë nuk hyn në sistemin e shpërndarjes, mbi të cilin ka kontroll KEK-u. Për më tepër, pas privatizimit, KKDFE nuk do të paguajë për atë energji, meqë ajo nuk shpërndahet në një zonë mbi të cilën ajo ka kontroll. Në aplikimin tarifor të KEK-ut, kostoja e asaj energjie është përfshirë në koston e përgjithshme të energjisë me shumicë, e cila është vetëm një opsion i zbatueshëm deri në zgjidhjen e çështjes së Kosovës Veriore. ZRRE nuk ka dhënë asnjë sqarim se pse ata nuk e kanë marrë në konsiderim propozimin e arsyeshëm dhe praktik të KEK-ut mbi këtë çështje. Vendimi 399 që ka të bëjë me humbjet nuk i ka ndarë humbjet politike nga ato teknike dhe komerciale për arsye të cilat ZRRE nuk i ka theksuar fare.

Tabela A: Krahasimi i Bilancit Energjetik - KEK dhe ZRRE

Pershkrimi	KEK Aplikacioni	Rregullimet e ZRRE-se	Propozimi ZRRE-se
Gjenerimi			
KEK Gjenerimi			
Kosova A	GWh	1,475	1,475
Kosova B	GWh	3,393	3,393
		4,868	4,868
Gjenerimi tjetër vendor			
HC Ujmani	GWh	82	82
Gjenerimi në nivel Distribucioni	GWh	52	52
Importet dhe eksportet			
Importet	GWh	821	801
Exportet	GWh	(170)	(184)
Humbjet në Transmision			
Humbjet në Transmision	GWh	(128)	(119)
Fuqia në nivel Transmisioni			
Shitjet për konsumatorët e kyqur në Transmision			
220kV(Feronikeli)	GWh	657	657
110kV(Sharrcem & Trepça)	GWh	88	88
Konsumi KEK-ut		131	131
Teprica		13	0
Hyrja në Distribucion	GWh	4,635	4,624
Humbjet në Distribucion dhe energjia e pafaturuar			
Humbjet Teknike	GWh	797	795
Humbjet Komerciale	GWh	723	621
Energjia për Veriun (shih Shenimin 1)	GWh	204	204
Humbjet Totale	GWh	1,724	1,620
Shitjet për konsumatorët e kyqur në Distribucion		2,912	3,004

Shenim 1: Në aplikimin e tij, KEK-u ka përfshirë kostën e kësaj energjie në Kostën e Energjisë me Shumicë

Ndryshimi fillestar në mes të KEK-ut dhe ZRRE-së për bilancin energjetik në përgjithësi është zvogëlimi i humbjeve komerciale për rreth 100 GWh dhe rritja e shitjeve të konsumatorëve për rreth të njëjtën vlerë. Kjo është bazuar në Vendimin 399 e lëshuar nga ZRRE më 6 shkurt 2012 për zvogëlimin e përgjithshëm të humbjeve të shpërndarjes për tre për qind nga niveli aktual i vitit 2011. Edhe pse KEK-u e ndjen që ai zvogëlim i humbjeve është agresiv, veçanërisht për vitet e ardhshme, në nuk kemi zgjidhje tjetër veçse të përdorim vlerat e ZRRE-së për humbje dhe shitje për qëllim të këtij aplikimi tarifor.

d) Qartësimi i Të Hyrave të Lejuara

KEK-u e ka të vështirë të komentojë në këtë Raport Konsultativ lidhur me Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) meqë ZRRE nuk e ka theksuar shumën e MAR-it që ata e propozojnë. Në RK të tyre, ZRRE sqaron një numër përshtatjesh që ata i kanë bërë në të Hyrat e Lejuara të kërkuara të

KEK-ut prej 239 milion €. Ata po ashtu kanë theksuar se ata lejojnë një rritje tarifore prej 7.6%. Nuk ka kurrfarë sqarimi se si është arritur deri te 7.6%; prandaj, KEK-u është dashur të zgjidhë enigmën për të përcaktuar variablat kryesore të nevojshme për të artitur deri te pozicioni i ZRRE-së.

Tabela B është përcaktimi më i mirë i KEK-ut për atë se cili është pozicioni i ZRRE-së. Ajo përdor Të Hyrat e Lejuara të kërkuara të KEK-ut prej 239 milionë eurosh dhe i bën përshtatjet për të gjitha rregullimet në Të Hyrat e Lejuara të diskutuara në Raportin Konsultativ për të arritur deri te pozicioni "Të Hyrat e Lejuara të Supozuara të ZRRE-së" prej 213 milion eurosh. Meqë ZRRE ka përshtatur nivelin e shitjeve me pakicë, siç u diskutua në seksioni c më sipër, ishte po ashtu e nevojshme që të përshtaten të hyrat e KEK-ut për vitin 2012 në nivelin tarifor aktual (194 milion €) përmes rritjes së shitjeve. Rezultatet e kësaj analize janë vlerësimi më i mirë i KEK-ut për pozicionin e ZRRE-së.

Tabela B: Pozicioni i Supozuar i ZRRE-së për Të Hyrat e Lejuara dhe Rritjen e Kërkuar Tarifore

(Të gjitha vlerat në Milion Euro)

Kerkesa e KEK-ut per Te Hyrat e Lejuara	239.2	
Rregullimet/Azhustimet e ZRRE-se:		
Azhustimet per Zhvleresim dhe Kthim:	(1.2)	Shënim 1
Baza e Aseteve te Rregulluara eshte azhustuar ne menyre te panjohur dhe MPKK poashtu eshte azhustuar.		
Ndryshimet ne Kostot e Importit te v. 2012	2.6	Shënim 2
Rikthim nga shpenzimet tarifore per O&M per 2011 te pa harx	(8.8)	Shënim 3
Kthimi për klientët nga tarifat e KOSTT-it	(3.8)	Shënim 4
Rekonsilimi i Kostos se Importit per v. 2011	4.5	Shënim 2
Te Hyrat e Ngritura nga Eksporti per v. 2011	(8.1)	Shënim 2
Ulja e marzhes së shitjes me pakicë nga 5% ne 3%	(5.0)	Shënim 5
Ndryshimet në Parashikimin e të Hyrave nga eksporti per v. 2011	(3.2)	Shënim 2
Ndryshimi neto në taksat e KOSTT-it dhe humbjeve nga shitje	1.4	Shënim 6
Shpenzimet e Borxhit te Keq	(1.3)	Shënim 7
Rekonsilimi per Taksen e Licenses se Gjenerimit per v. 2011	(0.6)	Shënim 2
Interesi nga Azhustimet e Viteve Paraprake	(1.9)	Shënim 8
Dallimet e Pashpjegueshme	(0.8)	Shënim 9
Te Hyrat e Lejuara te Supozuara nga ZRRE	213.0	
Te Hyrat e KEK-ut sipas Tarifave Aktuale		
	194.3	
Azhustimet e ZRRE per te Hyrat per shkak te shitjeve me te l	4.3	Shënim 10
Te Hyrat e Supozuara nga ZRRE sipas Tarifave Aktuale	198.6	
Ngritja e Supozuar e Tarifave sipas ZRRE		
	14.5	
Ngritja e Supozuar e Perqindjes sipas ZRRE		
	7.3%	

- Shënim 1: Shih diskutimin në Seksionin III. ZRRE-ja bëri shumë azhustime të padokumentuara dhe të pashpjegueshme të RAB dhe zhvleresimit dhe ndryshime të MPKK për zvogelim neto prej 1.2 Mil.Euro
- Shënim 2: Këto azhustime kanë të bëjnë me artikujt që përfundimisht janë të rikonsiliuara me vlerat aktuale
- Shënim 3: Shih diskutimin në Seksionin III - shuma është llogaritur gabimisht.
- Shënim 4: Azhustim totalisht i papershtatshem. Shih diskutimin në Seksionin III.
- Shënim 5: KEK-u nuk pajtohet mirepo nuk do ta kundërshtoj për 3%. Shih diskutimin në Seksionin III.
- Shënim 6: S'ka kundërshtim - Kjo rregullon të Hyrat e Lejuara të KEK-ut në 14.8 Miljon qe i jane lejuar KOSTT
- Shënim 7: KEK-u dhe ZRRE-ja përdorin 5% (siç thuhet në Vendimin e ZRRE-së # 399). Diferenca për shkak të ndryshimit të ZRRE-se në Te Hyrat e Lejuara
- Shënim 8: ZRRE ka shtuar interesin në azhustimin e vitit paraprak.
- Shënim 9: Ka rregullime shumë të ndryshme të bëra nga ZRRE-së duke shkaktuar këtë diferencë të pashpjegueshme.
- Shënim10: Siç u tha në Seksionin II c, KEK-u nuk ka kundërshtim në këtë rregullim.

III. Komentet e KEK-ut mbi Pozicionin e ZRRE-së

a) Pikat e Pajtit të Përgjithshëm

KEK-u pajtohet në përgjithësi me ZRRE-në për shumicën e çështjeve që ata i kanë ngritur dhe për përshtatjet rezultuese. Për shembull, përshtatjet për çmimin e energjisë së importuar, sasi të dhe çmimet për eksport, dhe ngarkesa për licencë janë në rregull, meqë këto pika janë nivelizuar me vlerat aktuale kur këto vlera aktuale janë të njohura. Interesi prej 7% për këto rregullime është po ashtu në rregull meqë aplikohet drejt në të dyja, kthimet mbi dhe ato nën.

Rregulla për Vendosjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik thekson se:

16. *Marzha me pakicë do të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot e lejuara të energjisë me shumicë dhe kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë. Ajo duhet të caktohet në atë nivel që:*

16.1. *T'i sigurojë FPEE-së përfitim të arsyeshëm që ta kompensojë për rreziqet që ndërmerr gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu*

referuar marzhave të fituara nga kompanitë e ngjashme në vendet e tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike dhe në ato vende dhe atë të Kosovës; dhe

16.2. *T'i sigurojë FPEE-së kthim të arsyeshëm nga asetet fikse neto të saj të përdorura gjatë ofrimit të shërbimit standard për konsumatorët e rregulluar. Kjo duhet të llogaritet duke iu referuar koston së kapitalit të të licencuarve të tjerë në Kosovë.*

KEK-u ka kërkuar një Marzhë me Pakicë prej 5% dhe ka sqaruar në aplikimin e tij tarifor që një rishikim i të dhënave të dispozicion nga OFGEM tregon një ndryshim të madh në marzhat me pakicë të cilat aktualisht fitohen nga furnizuesit e gazit dhe energjisë elektrike. Çështja qëndron se Furnizuesi Publik i Kosovës ka shumë më shumë rreziqe se sa kompanitë në vendet shumë të zhvilluara, prandaj KEK-u ka propozuar që Marzha me Pakicë të vendoset prej 5%. Meqë vlera është disi subjektive, KEK-u nuk ka ndonjë kundërshtim të madh me ZRRE-në për zvogëlimin e vlerës në 3%. KEK-u kundërshton, megjithatë deklaratat e ZRRE-së në RK se Marzha me Pakicë ka për qëllim vetëm të ofrojë një kthim në asetet themelore (pika 16.2 në rregullën e mësipërme). ZRRE duhet po ashtu të marrë në konsiderim pikën 16.1 në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve. Furnizuesit Publik kanë rrezik të konsiderueshëm dhe ky rrezik duhet të kompensohet në formën e një Marzhe me Pakicë.

Rregullimet e bëra nga ZRRE për ngarkesat e transmisionit për vitin 2012 bazohen në tarifat e KOSTT-it që propozohen dhe kanë për qëllim që t'i kenë Të Hyrat e Lejuara të KEK-ut për tarifat e transmisionit në vitin 2012 të njëjta me vlerën prej 14.8 milion € që po aprovohet për KOSTT-in. Ngjashëm, të hyrat e pritshme të KEK-ut nga shitja e energjisë në KOSTT për humbjet e transmisionit (3.9 milion €) korrespondojnë me nivelin e aprovuar për KOSTT-in.

“Ndryshimet e Pasqaruara” prej 0.8 milion € janë më të vogla dhe meqë KEK-u nuk ka bazë për kontestim të shumës, ne nuk po bëjmë asnjë kundërshtim.

KEK-u nuk po kundërshton të hyrat e supozuara shtesë prej 4.3 milion € që kanë të bëjnë me shitjet shtesë të supozuara nga ana e ZRRE-së në Bilancin e saj Energjetik. Siç është theksuar në Seksionin II c më sipër, kjo bazohet në Vendimin 399 të lëshuar nga ZRRE më 6 shkurt 2012 i cili ka zvogëluar humbjet e përgjithshme në shpërndarje për tre për qind nga niveli aktual i vitit 2011. Edhe pse KEK-u ndjen që objektivi për zvogëlimin e humbjeve është agresiv, veçanërisht për vitet e ardhshme, ne nuk kemi zgjidhje tjetër mirëpo vetëm të përdorim vlerat e humbjeve dhe shitjeve të ZRRE-së për qëllim të këtij aplikimi tarifor.

b) Përshtatjet e Kontestuara nga ana e KEK-ut

Disa përshtatje të bëra nga ZRRE janë duke u kontestuar dhe KEK-u kërkon nga ZRRE që të konsiderojë secilën prej çështjeve të prezantuara më poshtë dhe të bëjë përshtatjet në Të Hyrat e Lejuara të Propozuara nga ZRRE. Secila prej këtyre çështjeve është paraqitur në vijim.

ÇËSHTJA A: Mungesa e Qartësisë në Përcaktimin e Kostove të Ndërlidhura me Kapitalin.

Siç është theksuar në seksionin II d, KEK-u e ka të vështirë të komentojë në këtë Raport Konsultativ lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR), meqë ZRRE nuk ka theksuar shumën e MAR që ata e propozojnë. Shqetësues është fakti që KEK-ut nuk i është dhëna asnjë dokumentacion lidhur me mënyrën se si e ka përcaktuar ZRRE:

- Bazën e Aseteve të Rregullara (RAB)
- Bazën e Aseteve të Rregullara të Përshtatur për përcaktimin e Kthimit të të Hyrave (RABf)
- Zhvlerësimin e Lejuar

Shuma e padokumentuar për ato vlera kryesore dhe mënyra se si janë përdorur ato për përcaktimin e Zhvlerësimit të Lejuar dhe Kthimit të Lejuar e bën të vështirë për KEK-un komentimin e arsyeshmërisë së shumave që lejohen nga ana e ZRRE-së.

ZRRE thekson se ata nuk lejojnë që KEK-u të fitojë një kthim në asetet që KEK-u ka investuar para vitit 2006. Kjo nuk është në përputhje me (1) teorinë dhe praktikën financiare moderne ose (2) qëllimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Kostoja e aseteve të kompanisë duhet të mbulohet nga konsumatorët në formën e:

- Zhvlerësimit për të mbuluar koston e aseteve ndaj jetëgjatësisë së tyre (Kthimi i Investimit)
- Kthimit në Investim për të njohur që fondet që i kushtohen një investimi të asetit kanë një kosto.

ZRRE e njeh që të dyja komponentët e mbulimit të koston së kapitalit janë të nevojshme për të gjitha asetet, me përjashtim të kthimit në asetet që i kushtohen shërbimit të para vitit 2006. ZRRE duhet të arsyetojë në mënyrë racionale pse po e lejon komponentin e koston së zhvlerësimit në këto asete, mirëpo jo komponentin e kthimit. Sqarimi i dhënë në RK është: “ZRRE lejon zhvlerësimin, mirëpo nuk lejon kthimin në asetet e para vitit 2006 sepse nuk ka kosto financuese që ndërlidhen me këto asete”. Kjo është absolutisht jo e drejtë! KEK-u ka paguar për këto asete dhe duhet të kompensohet për koston e këtyre fondeve. Heqja e së drejtës për KEK-un dhe aksionarin e tij (Qeverinë e Kosovës) nga kjo komponentë standarde e mbulimit të koston paraqet një “konfiskim” të një pjese të koston së këtyre aseteve. Për më tepër, KEK-u nuk do të kishte rrjedhën e brendshme të parasë për të financuar zëvendësimet për ato asete ose për të bërë investimet e nevojshëm në projektet mjedisore, siç janë elektrofiltrat në blloqet Kosova A.

Ky konfiskim në fuqi krijon një subvencion të fshehur nga Qeveria për konsumatorët e energjisë elektrike. Subvencionet e tilla nuk janë në pajtueshmëri me qëllimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, i cili kërkon që tarifatat të jenë kosto reflektive.

ÇËSHTJA B: Llogaritja e Pasaktë e Kostove të Pashpenzuara të Operimit dhe Mirëmbajtjes për vitin 2011

ZRRE ka bërë një llogaritje të pasaktë të shumës përmes së cilës koston e Operimit dhe Mirëmbajtjes (O&M) për vitin 2011 ishin më të ulëta se sa shuma e lejuar në tarifatat e vitit 2011. ZRRE ka përzgjedhur disa kategori shpenzimesh që kishin vlerësime më të ulëta shpenzimesh se sa që ishin të lejuara në tarifa. KEK-u kundërshton këtë qasje nga dy pikëpamje. E para, kur KEK-u ka plotësuar pasqyrën e të dhënave të ZRRE-së, ne kemi theksuar se (1) shumatat ishin të bazuara në vlerësimet preliminare meqë librat nuk ishin mbyllur dhe (2) kategoritë ishin arbitrare meqë KEK-u nuk i konsideron koston në atë mënyrë specifike.

Që nga koha kur janë dhënë ato vlerësime preliminare, KEK-u i ka mbyllur librat dhe ka përgatitur draft pasqyrat financiare për t'i paraqitur te auditori i jashtëm për rishikim. ZRRE-së po i jepen shpenzimet e O&M 2011 të cilat janë pjesë e atyre raporteve (mbi baza konfidenciale) në të njëjtën kohë kur po jepet kjo përgjigje (në të njëjtin format si të dhënat e O&M për periudhën 2008-2010 që ishin siguruar për ZRRE-në). Rezultatet tregojnë se koston O&M për vitin 2011 ishin 101 milion €. Kur ajo vlerë krahasohet me 105 milion € që ZRRE i ka lejuar në tarifatat e vitit 2011, rregullimi për nën-shpenzim është qartë 4 milion €, dhe jo 8.8 milion €, që ZRRE ka përfshirë në rregullimin e saj.

Prandaj, KEK-u kërkon nga ZRRE që të rrisë të Hyrat e tij të Lejuara përmes shumës së arsyetuar prej 4.8 milion € për këtë pikë.

ÇËSHITJA C: Zvogëlimi i Pavend i Të Hyrave të Lejuara për vitin 2012 për Ngarkesat e Transmisionit të vitit 2010

ZRRE ka bërë një përshtatje jo të drejtë në zvogëlimin prej 3.8 milion € nga Të Hyrat e Lejuara të KEK-ut 2012 për ngarkesat e transmisionit 2010 të cilat e tejkalojnë:

1. Shumën të cilën KEK-ut i ishte lejuar ta përfshinte në tarifatat me pakicë, dhe
2. Shumën për të cilën ZRRE ndjen se i takon Operatorit të Sistemit të Transmisionit

Çështja e ngarkesave të transmisionit që i ngarkohen KEK-ut, të cilat i tejkalojnë shumatat që i lejohen KEK-ut për t'i ngarkuar konsumatorët e tij, është diskutuar gjatë në mes të ZRRE-së, KOSTT-it dhe KEK-ut për një kohë. Më 29 shkurt 2012 (dy ditë pasi që është lëshuar Raporti Konsultativ për tarifa), ZRRE ka nxjerrë Vendimin e tij 400 në çështjen e kontestit KEK/KOSTT për pagesën e ngarkesave të transmisionit. KEK-u është duke bërë ankesë për atë Vendim në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke kërkuar nga kjo e fundit që Vendimi i ZRRE-së të mos pranohet meqë ai është i pavend në shumë aspekte (disa prej të cilave do të diskutohen këtu).

Për ta thjeshtësuar, zvogëlimi prej 3.8 milion € i të hyrave të lejuara të KEK-ut për vitin 2012 sidoqoftë nuk është bazuar në asnjë logjikë. Në seksionin 6.2 të RK, ZRRE-ja thekson se shuma në fjalë tejkalon të hyrat që ZRRE i ka aprovuar për KOSTT-in dhe shumën e përfshirë në të hyrat e KEK-ut. Kjo çështje është e qartë: (1) shuma është më tepër se sa shuma që i takon KOSTT-it dhe (2) është më tepër se shuma që KEK-u ka qenë i lejuar ta bartë në tarifatat me pakicë. Nuk ekziston kurrfarë logjike e cila do të arsyetonte përshtatjet në të hyrat e lejuara të KEK-ut për 2012, që është në fakt një "kompensim" i konsumatorëve për shumatat që ata nuk i kanë paguar kurrë.

KOSTT-i ka pohuar se shuma në fjalë është për shkak të vëllimeve të mëdha të energjisë së transmetuar. Kjo është e pavërtetë. Tabela C paraqet Bilancin Energjetik 2010 që përdoret për zhvillimin tarifor krahasuar me rezultatet aktuale në atë vit. Tabela qartë tregon që:

- Energjia e furnizuar në nivelin e transmisionit ishte vetëm 2% më e lartë se sa ajo e parashikuar. Faktet kontestojnë pohimin se KOSTT-i ka trajtuar vëllime më të mëdha
- Shitjet te konsumatorët ishin 1% më të ulëta se sa ato të parashikuara. Kjo rezulton në konsumatorë që nuk ngarkohen më shumë për kosto transmisioni (ose të tjera) bazuar në vëllimet që ata faturohen
- Humbjet e Transmisionit ishin 21% më të ulëta se sa ato të parashikuara. Meqë kostoja e humbjeve është një komponentë e kostonë së transmisionit, KOSTT-i ka tej-kthyer (tejmbuluar) këtë kosto. Siç është paraqitur në Tabelën C, humbjet ishin 35 GWH më të ulëta se sa ato të parashikuara. Në çmimin për humbjet në 2010 (33 € për MWH), shuma e përfshirë është më tepër se 1 milion €.

Tabela C: Bilanci Energjetik 2010 i përdorur për Tarifat e Krahasuara me Rezultatet Aktuale

2010 Bilanci Energjise	ZRRE Vendimi Tarifor	2010 Rezultatet Aktuale	% Devijimi nga Parashikimi
KEK Gjenerimi	4,578	4,861	6%
Blerjet nga Ujmani	68	114	68%
Importi	860	685	-20%
Eksporti	193	215	11%
Furnizimi Total ne nivel te Transm	5,313	5,445	2%
Humbjet ne Transmision	166	131	-21%
Shitjet ne nivel Transmisioni	719	701	-3%
Konsumi i Brendshem	146	90	-38%
Gjenerimi i lidhur ne nivel Distribucion	23	42	83%
Hyrja ne Distribucion	4,305	4,565	6%
Shitjet per Konsumatorët e Distrib	2711	2673	-1%

Rregulla për Vendosjen e Çmimeve të FPEE-së (Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike) mbështet pozicionin e KEK-ut në këtë çështje. Ajo thekson se kostot e arsyeshme të FPEE-së do të përfshijnë:

“Kostot e Bartshme, përfshirë ngarkesën OM, ngarkesën OS, atë TNUOS, ngarkesën DUOS dhe taksën e licencës, të cilat do të jenë plotësisht të barrshme në Azhurnimet Vjetore”

Ngarkesa OM, OS dhe TNUOS janë pikat që përbëjnë ngarkesat e transmisionit në fjalë. KEK-u ka theksuar vazhdimisht se është i gatshëm t'i paguajë KOSTT-it çfarëdo shume që KEK-ut i lejohet ta bartë te konsumatorët me pakicë. KEK-u vetëm ka refuzuar t'i paguajë KOSTT-it shumat të cilat nuk është në gjendje t'i bartë te konsumatorët. Përsëri, nuk ekziston kurrfarë logjike në Vendimin e ZRRE-së nr 400 për zvogëlimin e Të Hyrave të Lejuara të KEK-ut për 2012 për shumat që ZRRE e pranon se nuk i takojnë KOSTT-it, për të cilat konsumatorët nuk janë ngarkuar dhe për të cilat konsumatorët në vend të parë nuk kanë paguar kurrë.

Siç ka theksuar KEK-u në disa dokumente që ndërlidhen me këtë kontest, arsyeja kryesore që KOSTT-i faturon shumat më tepër se të hyrat e tij të lejuara është për shkak të faktit se tarifatat individuale të transmisionit janë disejnuar jo drejt në vitin 2009 për të mbuluar më shumë se të hyrat e lejuara të KOSTT-it. Kjo do të duhej të ishte shumë e qartë për ZRRE-në gjatë rishikimit tarifor 2009, kur ka rritur çmimet individuale të transmisionit për mbi 25%, pa asnjë arsytim të qartë meqë të hyrat e lejuara të KOSTT-it nuk janë rritur askund afër atij niveli. Natyrisht, lejimi i ngarkesave të transmisionit në tarifatat e KEK-ut nuk ishte përshtatur në mënyrë përkatëse. KEK-u ka ngritur këtë çështje në ZRRE përmes një letre të datës 21 prill 2009; megjithatë, ZRRE nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimi. Në proceset e rishikimeve tarifore 2010 dhe 2011, ZRRE ka kuptuar përfundimisht se çmimet e ndryshme do të duhej të zvogëloheshin dukshëm dhe ata e bënë këtë.

Pikat e diskutuara më sipër dhe faktet e tjera të konsiderueshme po përfshihen në ankesën e KEK-ut para Gjykatës Supreme.

Një çështje e rëndësishme tjetër është shuma prej 3.8 milion €. Pasi që menaxhmenti i KEK-ut ka lexuar Vendimin e ZRRE-së të 29 shkurtit, ai ka hetuar pohimin që KOSTT-i ka bërë në ZRRE se KOSTT-i ka paguar faturat e muajit nëntor dhe dhjetor 2010 për humbjet e transmisionit. Hetimi ka shpalosur se këto fatura ishin paguar (në shumën prej 1.0 milion €) në të vërtetë në prill dhe maj 2011. Tani që kjo gjë është e ditur, është e duhur që KEK-u t'i paguajë KOSTT-it një shumë të barabartë për ngarkesat e transmisionit. Ajo pagesë do të rezultojë në pagesën e plotë të shumës neto prej 12.5 milion €, të përfshirë në tarifat me pakicë për ngarkesat e transmisionit që i paguhen KOSTT-it. Ky duhet të jetë përfundimi final i kësaj çështjeje. Asnjë zvogëlim i të hyrave të lejuara nuk është i përshtatshëm.

Prandaj, KEK-u kërkon nga ZRRE që të rrisë Të Hyrat e saj të Lejuara përmes shumës së arsyetuar prej 3.8 milion € për këtë pikë

IV. Të Hyrat e Lejuara të Propozuara dhe Rritja Tarifore e Kërkuar – Të përshtatura

Edhe pse KEK-u mban të drejtën për të kontrolluar llogaritjet e detajizuara të ZRRE-së sa i përket RAB, RABf, dhe Zhvlerësimit, siç është diskutuar në seksionin III b, KEK-u propozon në këtë fazë që të bëhen dy përshtatje specifike në Të Hyrat e Lejuara të Supozuara të ZRRE-së prej 213 €, të paraqitura në Tabelën B. Ato përshtatje janë për dy çështjet e ngritura në seksionin III:

- Çështja B: Llogaritja Jo e Drejtë e Kostove O&M të Pashpenzuara të vitit 2011 dhe
- Çështja C: Zvogëlimi Jo i Duhur i Të Hyrave të Lejuara të KEK-ut 2012 për Ngarkesat e Transmisionit 2010

Bazuar në përshtatjet dhe Të Hyrat e Supozuara me Tarifat Aktuale, KEK-u kërkon nga ZRRE që të rishikojë Të Hyrat e Lejuara të saj dhe rritjen tarifore si rezultat, ashtu siç është paraqitur në Tabelën D në vijim.

Tabela D: Rishikimi i Të Hyrave të Lejuara të Supozuara të ZRRE-së dhe Rritja Tarifore e Kërkuar

	(Milionë euro)
Të Hyrat e Lejuara të Supozuara të ZRRE-së:	213.0
Përshtatjet të Bazuara në Çështjet Kryesore të Ngritura:	
Përshtatja O&M 2011 (Çështja B)	4.8
Zvogëlimi Jo i Duhur për Ngarkesat e Transmisionit	3.8
Rishikimi i Të Hyrave të Lejuara	221.6
Të Hyrat e Supozuara 2012 me Tarifat Aktuale	198.6
Rritja e Kërkuar në Tarifa	23.0
	11.6 %

KEK-u po pret që ZRRE të përdorë përcaktuesit e faturimit që KEK-u i ka dorëzuar në aplikimin e tij tarifor, të përshtatur për rritjen në shitjet që i ka bërë ZRRE në Bilancin e saj Energjetik. Ajo është një qasje e duhur për të siguruar që niveli i Të Hyrave të Lejuara po mbulohet në tarifat e propozuara. Për lehtësi, KEK-u ka rishikuar Përcaktuesit e Faturimit 2012 për të qenë konform nivelit të shitjeve të ZRRE-së dhe i ka përfshirë ato në Shtojcën A.

V. Propozimi i Tarifave të Reja Bazuar në Rishikimin e Të Hyrave të Lejuara

ZRRE ka theksuar në RK që struktura e tarifave ekzistuese do të mbetet e pandryshuar. Duke marrë parasysh kohën shumë të kufizuar të këtij rishikimi tarifor, që është i arsyeshëm, veçanërisht duke ditur që KEK-u nuk mund ta inkorporojë një ndryshim strukturor në sistemin e tij të faturimit brenda një njoftimi kaq të shkurtër. Natyrisht, çmimet individuale (kërkesa gjatë ditës, natës, gjatë dimrit, verës dhe ngarkesa e konsumatorit) mund të rishikohen. Siç është diskutuar në seksionin II b, KEK-u është i shqetësuar që ata nuk kanë për qëllim të lëvizin drejt tarifave kosto reflektive në këtë rishikim tarifor.

Siç e ka dokumentuar KEK-u në aplikimin e tij tarifor, tarifat e amvisërisë janë dukshëm nën kosto dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë specifikon që "Subvencionet e tërthorta do të ri-balancohen në mënyrë graduale deri më 31 dhjetor 2014, prej së cilës pikë e tutje nuk do të ketë më subvencione të tërthorta". Kjo është veçanërisht e rëndësishme meqë amvisëritë paraqesin shumicën e shitjeve të energjisë. Nëse ZRRE e humb këtë shans, do të jenë vetëm edhe dy rishikime të tjera tarifore në të cilat mund të plotësohet kjo kërkesë. Meqë tarifat e amvisërisë aktualisht mbulojnë vetëm 65% të koston, siç është dokumentuar në Pjesën V të aplikimit tarifor të KEK-ut (i cili nuk do të ndryshojë shumë me përdorimin e të hyrave të lejuara të ZRRE-së), në këtë rishikim tarifor nuk duhet të humbet mundësia për të lëvizur në mënyrë graduale ashtu siç është humbur në rishikimet e mëparshme tarifore. Në mënyrë të ngjashme, meqë shumica e kategorive të tjera tashmë paguajnë më shumë se kosto për të marrë shërbimin, nuk është e drejtë, në rregull ose e arsyeshme që ato të rriten me të njëjtën përqindje sikurse amvisëritë. Një subvencion i tillë i tërthortë nuk mund të tolerohet në një mjedis tregu të cilin Kosova shpreson ta arrijë brenda disa viteve në të ardhmen. Tregjet konkurruese nuk mund të funksionojnë në një situatë të tillë, veçanërisht nëse konsumatorët e amvisërisë pritet të bëhen konsumatorë të privilegjuar në vitin 2015.

Siç u diskutua më herët, KEK-u pohon që kthimi në asetete e para vitit 2006 duhet të përfshihet në tarifa, prandaj vlerat e Të Hyrave të Lejuara në Tabelën D duhet të rriten. Megjithatë, në rast se ZRRE vetëm adapton rritjen e përgjithshme në tarifat e paraqitura në Tabelën D, KEK-u rekomandon që tarifat e amvisërisë të rriten për më shumë se sa rritja e përgjithshme e përqindjes dhe kategoritë e tjera tarifore të rriten për më pak se sa ajo vlerë.

Nëse qëllimi ka qenë që të ri-balancohen tarifat sa më shpejt që të jetë e mundur për të plotësuar standardin për reflektim të koston, e gjithë rritja do t'i caktohej amvisërive. Një objektivë e tillë nuk është praktike përderisa shoku i amvisërisë do të ishte shumë i madh dhe nuk do të ishte as e pranueshme në aspektin social që t'i jepnin amvisërisë një rritje kaq të madhe dhe të mos i rrisnin tarifat për kategoritë e tjera të konsumatorëve. Një objektivë e mirë do të ishte që t'i lëviznin tarifat e amvisërisë për rreth 12% më afër nivelit për reflektim të koston në secilin prej 3 viteve të ardhshme (2012, 2013, dhe 2014) meqë ato aktualisht po mbulojnë vetëm 65% të kostove.

KEK-u rekomandon që rritja e tarifave t'i caktohet kategorive të konsumatorëve të paraqitur në Tabelën E. Të gjitha kategoritë e tarifave do të pranonin një rritje 5% dhe pjesa e mbetur për mbulimin e të hyrave të lejuara t'i caktohet amvisërive.

Tabela E: Propozimi për Caktimin e Të Hyrave të Lejuara për Klasat Tarifore

Kategorit Tarifore	Faturuar me	5.0%	Shtesat e	Faturimi me tarifate	
	Tarifat e 2011	Ngritje	Ngritjes	propozuara	
	Total €	Te gjitha kategorite	Total €	Total €	% Ngritjes
220kV	27,791,312	29,180,878	0	29,180,878	5.00%
110 kV	3,677,688	3,861,572	0	3,861,572	5.00%
35 kV	2,458,392	2,581,311	0	2,581,311	5.00%
10 kV	13,410,968	14,081,517	0	14,081,517	5.00%
0.4 kV Komercial te medhenje	17,005,071	17,855,324	0	17,855,324	5.00%
0.4 kV Komercial te vegjel	34,761,725	36,499,811	0	36,499,811	5.00%
0.4 kV (2-vleresh shtepiak)	90,028,347	94,529,764	13,000,000	107,529,764	19.44%
0.4 kV (1- vleresh shtepiak)	6,900,731	7,245,767	600,000	7,845,767	13.69%
0.4 kV (shtepiak pa mates)	980,570	1,029,598	0	1,029,598	5.00%
Ndricimi publik	1,067,107	1,120,462	0	1,120,462	5.00%
Total	198,081,909	207,986,005	13,600,000	221,586,005	11.87%

Alokimi i mësipërm rezulton në çmimet mesatare për kWh si në vijim:

Çmimi mesatar për të gjithë konsumatorët	<u>Aktualisht</u> 5.3 ¢/kWh	<u>I propozuar</u> 5.9 ¢/kWh
Çmimi mesatar për amvisëri	4.6 ¢/kWh	5.5 ¢/kWh

Meqenëse materialet e detajzuara të përfshira në aplikimin tarifor të KEK-ut kanë treguar se tarifa kosto reflektive për amvisëri është 7.2 centë për kWh (e cila përfshin caktimin e plotë të subvencionit të importit), rritja e propozuar prej 4.6 centë në 5.5 centë është një hap i parë racional drejt eliminimit të subvencionit të tërthortë masiv të cilin e pranon kjo kategori. Nëse llogaritjet e tarifave kosto reflektive janë rishikuar për të pasqyruar të Hyrat e Lejuara të ZRRE-së disi më të ulëta, atëherë rezultati do të ndryshohej shumë pak.

Siç e ka diskutuar KEK-u në aplikimin e tij tarifor, edhe pse nuk do të ketë kohë që të ridisejohet dukshëm struktura e tarifave individuale me pakicë, përshtatjet mund të caktohen në mënyrë strategjike, për të plotësuar kërkesat e Nenit 16 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të FPEE lidhur me reflektimin e kostos dhe ruajtjen e shenjave të çmimit. KEK-u propozon që përshtatjet në tarifate individuale të bëhen në mënyrën vijuese:

- Meqenëse tarifate jo të amvisërisë përmbajnë shenja të konsiderueshme të çmimit për sa i përket kohës së vitit dhe kohës së ditës dhe tarifate për konsumatorët më të mëdhenj përmbajnë komponentët e kërkesës, rritja do të aplikohet në mënyrë të barabartë te secili përcaktues i faturimit.
- Për amvisëritë, ekziston një problem serioz me regjistrimin e kohës së shfrytëzimit nga shumica e këtyre konsumatorëve. Meqë shumë konsumatorë nuk kanë njehsorë të besueshëm elektronikë, koha e shfrytëzimit rrallë që është më e mira. Kjo është pjesërisht si rezultat i reduktimit të energjisë dhe pjesërisht për shkak të faktit se konsumatorët mund të ndërhyjnë vetë në orar të njehsorët që nuk janë të sigurt. Duke ditur (1) pasaktësinë e orëve për këta konsumatorë dhe (2) mungesën e diferencimit të kohës në çmimin e energjisë me shumicë, KEK-u rekomandon që pjesa më e madhe e rritjes të caktohet për tarifate gjatë natës (23:00 deri 8:00 ose 22:00 deri 7:00, varësisht nga sezoni), të cilat në shumicën e rasteve janë shumë më të ulëta se sa kostoja e energjisë me shumicë. Në këtë moment, KEK-u nuk po rekomandon ndonjë ndryshim në strukturën tri bllokëshe të tarifave të amvisërisë, edhe pse ajo është një skemë tej-komplekse (tri blloqe, secila me nga një çmim ditor dhe çmim të natës) e cila nuk përdoret në shumicën e vendeve të tjera. Ajo situatë mund të adresohet në rishikimet tarifore në të ardhmen.

Parimet e mësipërme janë inkorporuar në tarifate e propozuara të prezantuara në Bashkëngjitjen A. Tarifate e natës për amvisëri janë rritur dukshëm për arsyt e paraqitura më sipër. Tarifate e ditës

gjatë verës janë rritur më shumë se sa tarifat e ditës gjatë dimrit, për të pasqyruar faktin se çmimet e energjisë me shumicë të sjella nga Furnizuesi Publik nuk e arsyetojnë diferencimin e konsiderueshëm në çmimet me pakicë. Bilanci Energetik 2012 i përdorur nga ZRRE tregon se Kosova po importon energji çdo muaj të vitit, duke përfshirë edhe verën. Edhe me përshtatjet e përmendura, secili mund të shohë se shenjat e çmimeve ditore dhe sezonale janë ruajtur, me kusht që konsumatorët me stimulim të mjaftueshëm të ndryshojnë ngarkesën (deri në shkallën që ata kanë mundësi) dhe të kursejnë kostot e tyre të energjisë.

KEK-u kërkon nga ZRRE që të aprovojë tarifat e propozuara ashtu siç janë paraqitur në Bashkëngjitjen A. Në rast se ZRRE përdor një vlerë tjetër për Të Hyrat e Lejuara, KEK-u kërkon që ZRRE të përdorë mostrën e përcaktuesit të faturimit në Bashkëngjitjen A dhe të përdorë parimet e diskutuara këtu mbi caktimin e rritjes së çmimit.

Si gjithmonë, KEK-u është në dispozicion për t'u takuar me ZRRE-në në çdo kohë, në mënyrë që të diskutojnë çështjet e ngritura në këtë përgjigje ndaj RK. Përveç kësaj, versionet elektronike të të gjitha tabelave do t'i dorëzohen ZRRE-së dhe ato do të jenë të zbërthyer të hapura, në mënyrë që ZRRE të mund t'i shfrytëzojë gjatë punës së saj.

Përcaktuesit e Faturimit për Vitin 2012

Grupi Tarifor	Percaktuesit e Faturimit		2012 Percaktuesit e Faturimit	Tarifat		% e çmimit te ngritur	Te hyrat me çmimin e propozuar	
	Pershkrimi Njesive Matese	Njes.Fatur. Mujore		Ekzistuese	Te Hyrat me tarifat ekzistues		çmimi Propozuar	
220kV Industrial	Faturat e Konsumat	€	12	167.67	€ 2,012	496%	1,000.00	€ 12,000
	KW	€/kW	1,080,000	13.26	€ 14,320,800	5.00%	13.92	€ 15,033,600
	Sezona Veres							
	Piku	€/kWh	209,320,200	2.05	€ 4,291,064	5.00%	2.15	€ 4,500,384
	Jashte-Pikut	€/kWh	125,618,400	2.05	€ 2,575,177	5.00%	2.15	€ 2,700,796
	Sezona Dimrit							
	Piku	€/kWh	201,304,800	2.05	€ 4,126,748	5.00%	2.15	€ 4,328,053
	Jashte-Pikut	€/kWh	120,756,600	2.05	€ 2,475,510	5.00%	2.15	€ 2,596,267
	Energjia Reaktive	€/kVARh			€ 0			
			657,000,000					
Total te hyrat ne kategorine tarifore					€ 27,791,312			€ 29,171,100
0 Industrial 110kV	Faturat e Konsumat	€	24	83.83	€ 2,012	1093%	1,000.00	€ 24,000
	KW	€/kW	187,208	5.59	€ 1,046,493	5.00%	5.87	€ 1,098,911
	Sezona Veres							
	Piku	€/kWh	27,862,799	1.92	€ 534,966	5.00%	2.02	€ 562,829
	Jashte-Pikut	€/kWh	23,724,394	1.58	€ 374,845	5.00%	1.66	€ 393,825
	Sezona Dimrit							
	Piku	€/kWh	19,721,141	6.49	€ 1,279,902	5.00%	6.81	€ 1,343,010
	Jashte-Pikut	€/kWh	16,276,667	2.70	€ 439,470	5.00%	2.84	€ 462,257
	Energjia Reaktive	€/kVARh						
			87,585,000					
Total te hyrat ne kategorine tarifore					€ 3,677,688			€ 3,884,832
1 (35 kV)	Faturat e Konsumat	€	318	11.08	€ 3,523	5.00%	11.63	€ 3,698
	KW	€/kW	90,994	5.81	€ 528,675	5.00%	6.10	€ 555,063
	Sezona Veres							
	Piku	€/kWh	11,838,150	2.94	€ 348,042	5.00%	3.09	€ 365,799
	Jashte-Pikut	€/kWh	7,946,945	2.65	€ 210,594	5.00%	2.78	€ 220,925
	Sezona Dimrit							
	Piku	€/kWh	12,307,420	6.79	€ 835,674	5.00%	7.13	€ 877,519
	Jashte-Pikut	€/kWh	8,007,485	3.59	€ 287,469	5.00%	3.77	€ 301,882
	Energjia Reaktive		37,032,632	0.66	€ 244,415	5.00%	0.69	€ 255,525
			40,100,000					
Total te hyrat ne kategorine tarifore					€ 2,458,392			€ 2,580,411
2 (10 kV)	Faturat e Konsumat	€	2,664	4.58	€ 12,201	5.00%	4.81	€ 12,814
	KW	€/kW	555,111	5.01	€ 2,781,106	5.00%	5.26	€ 2,919,884
	Sezona Veres							
	Piku	€/kWh	67,632,974	3.39	€ 2,292,758	5.00%	3.56	€ 2,407,734
	Jashte-Pikut	€/kWh	29,569,701	3.09	€ 913,704	5.00%	3.24	€ 958,058
	Sezona Dimrit							
	Piku	€/kWh	74,930,829	7.61	€ 5,702,236	5.00%	7.99	€ 5,986,973
	Jashte-Pikut	€/kWh	32,866,496	4.10	€ 1,347,526	5.00%	4.31	€ 1,416,546
	Energjia Reaktive		54,763,180	0.66	€ 361,437	5.00%	0.69	€ 377,866
			205,000,000					
Total te hyrat ne kategorine tarifore					€ 13,410,968			€ 14,079,875

A

Grupi Tarifor	Percaktuesit e Faturimit		2012	Tarifat		% e çmimit te ngritur	Te Hyrat me	
	Pershkrimi Njesive Matese	Njes.Fatur. Mujore		Percaktuesit e Faturimit	Ekzistuese		tarifat ekzistues	Çmimi Propozuar
3 Kategoria I (0.4 kV) (konsumatorët e medhenje te energjise reaktive)	Multi-Tarifor							
	Faturat e Konsumat	€	17,596	2.58	€ 45,398	5.00%	2.71	€ 47,685
	KW	€/kW	990,586	2.91	€ 2,882,605	5.00%	3.06	€ 3,031,193
	Sezona Veres							
	Piku	€/kWh	82,769,391	4.69	€ 3,881,884	5.00%	4.92	€ 4,072,254
	Jashte-Pikut	€/kWh	28,367,024	4.43	€ 1,256,659	5.00%	4.65	€ 1,319,067
	Sezona Dimrit							
	Piku	€/kWh	82,081,341	8.45	€ 6,935,873	5.00%	8.87	€ 7,280,615
	Jashte-Pikut	€/kWh	30,348,900	5.33	€ 1,617,596	5.00%	5.60	€ 1,699,538
Energjia Reaktive	€/kVARh	58,341,599	0.66	€ 385,055	5.00%	0.69	€ 402,557	
			223,566,656					
	Total te hyrat ne kategorine tarifore				€ 17,005,071			€ 17,852,909
4 Kategoria II (0.4 kV) (komercial te vegjel) 1 tarifor	Tarifa e Vetme							
	Faturat e Konsumat	€	207,471	2.92	€ 605,815	5.00%	3.07	€ 636,936
	Sezona Veres	€/kWh	20,500,239	6.73	€ 1,379,666	5.00%	7.07	€ 1,449,367
	Sezona Dimrit	€/kWh	27,035,490	10.41	€ 2,814,395	5.00%	10.93	€ 2,954,979
					€ 4,799,876			€ 5,041,282
4 Kategoria II (0.4 kV) (komercial te vegjel) 2 tarifor	Faturat e Konsumatoreve		567,887	2.92	€ 1,658,230	5.00%	3.07	€ 1,743,413
	KW	€/kW						
	Sezona Veres							
	Piku	€/kWh	81,725,068	8.21	€ 6,709,628	5.00%	8.62	€ 7,044,701
	Jashte-Pikut	€/kWh	80,909,641	4.10	€ 3,317,295	5.00%	4.31	€ 3,487,206
	Sezona Dimrit		0					
	Piku	€/kWh	100,756,132	12.53	€ 12,624,743	5.00%	13.16	€ 13,259,507
	Jashte-Pikut	€/kWh	90,286,773	6.26	€ 5,651,952	5.00%	6.57	€ 5,931,841
			401,213,344		€ 29,961,849			€ 31,466,668
	Total te hyrat ne kategorine tarifore (1 Tarifore dhe 2 Tarifor)				€ 34,761,725			€ 36,507,949
5 0.4 kV matesi 2 tarifor (2-vleresh shtepiak)	Faturat e Konsumat	€	3,866,825	2.08	€ 8,042,996	8.17%	2.25	€ 8,700,356
	< 200 kWh							
	Sezona Veres							
	Piku	€/kWh	156,631,479	3.33	€ 5,215,828	15.00%	3.83	€ 5,998,986
	Jashte-Pikut	€/kWh	171,799,216	1.66	€ 2,851,867	35.00%	2.24	€ 3,848,302
	Sezona Dimrit							
	Piku	€/kWh	152,911,863	4.64	€ 7,095,110	10.00%	5.10	€ 7,798,505
	Jashte-Pikut	€/kWh	168,508,989	2.33	€ 3,926,259	34.10%	3.12	€ 5,257,480
	200-600 kWh							
	Sezona Veres							
	Piku	€/kWh	173,971,483	4.60	€ 8,002,688	15.00%	5.29	€ 9,203,091
	Jashte-Pikut	€/kWh	221,197,388	2.31	€ 5,109,660	35.00%	3.12	€ 6,901,358
	Sezona Dimrit							
	Piku	€/kWh	190,421,041	6.43	€ 12,244,073	10.00%	7.07	€ 13,462,768
	Jashte-Pikut	€/kWh	243,020,630	3.22	€ 7,825,264	34.10%	4.32	€ 10,498,491
	> 600 kWh							
	Sezona Veres							
	Piku	€/kWh	71,909,428	6.68	€ 4,803,550	15.00%	7.68	€ 5,522,644
	Jashte-Pikut	€/kWh	94,758,668	3.35	€ 3,174,415	35.00%	4.52	€ 4,283,092
Sezona Dimrit								
Piku	€/kWh	137,148,921	9.33	€ 12,795,994	10.00%	10.26	€ 14,071,479	
Jashte-Pikut	€/kWh	191,859,244	4.66	€ 8,940,641	34.10%	6.25	€ 11,991,203	
			1,974,138,351					
	Total te hyrat ne kategorine tarifore				€ 90,028,347			€ 107,537,757

Grupi Tarifor	Percaktuesit e Faturimit		2012 Percaktuesit e Faturimit	Tarifat		% e çmimit te ngritur	Te hyrat me çmimin e propozuar	
	Pershkrimi Njesive Matese	Njes.Fatur. Mujore		Ekzistuese	tarifat ekzistues		Çmimi Propozuar	
6 0.4 kV matesi 1 tarifor (1-vleresh shtepiak)	Faturat e Konsumat	€	503,064	2.08	€ 1,046,373	8.17%	2.25	€ 1,131,894
	< 200 kWh							
	Sezona Veres	€/kWh	31,881,942	2.96	€ 943,705	18.00%	3.49	€ 1,112,680
	Sezona Dimrit	€/kWh	32,029,321	4.14	€ 1,326,014	12.50%	4.66	€ 1,492,566
	200-600 kWh							
	Sezona Veres	€/kWh	23,761,701	4.10	€ 974,230	18.00%	4.84	€ 1,150,066
	Sezona Dimrit	€/kWh	25,570,166	5.73	€ 1,465,171	12.50%	6.45	€ 1,649,276
	> 600 kWh							
	Sezona Veres	€/kWh	6,051,238	5.96	€ 360,654	18.00%	7.03	€ 425,402
	Sezona Dimrit	€/kWh	9,441,446	8.31	€ 784,584	12.50%	9.35	€ 882,775
			128,735,814					
Total te hyrat ne kategorine tarifore					€ 6,900,731			€ 7,844,659
7 0.4 kV (shtepiak pa mates)	Faturat e Konsumat	€	18,701	21.50	€ 402,072	5.00%	22.58	€ 422,269
	< 400 kWh							
	Sezona Veres	€/kWh	3,217,972					
	Sezona Dimrit	€/kWh	4,282,077					
	Faturat e Konsumat	€	12,525	38.92	€ 487,473	5.00%	40.87	€ 511,897
	400-800 kWh							
	Sezona Veres	€/kWh	4,113,843					
	Sezona Dimrit	€/kWh	5,114,324					
	Faturat e Konsumat	€	1,388	65.58	€ 91,025	5.00%	68.86	€ 95,578
	> 800 kWh							
Sezona Veres	€/kWh	769,179						
Sezona Dimrit	€/kWh	978,139						
			18,475,533					
Total te hyrat ne kategorine tarifore					€ 980,570			€ 1,029,743
8 Ndrçimi publik	Faturat e Konsumat	€	7,886	2.92	€ 23,027	5.00%	3.07	€ 24,210
	Sezona Veres	€/kWh	6,200,000	8.42	€ 522,040	5.00%	8.84	€ 548,080
	Sezona Dimrit	€/kWh	6,200,000	8.42	€ 522,040	5.00%	8.84	€ 548,080
				12,400,000				
Total te hyrat ne kategorine tarifore					€ 1,067,107			€ 1,120,370
Total te Hyrat Vjetore per te gjitha Kategorite Tarifore me larte					€ 198,081,909			€ 221,609,606